



# POTENCIALI I MARRËVESHJES SË GJELBËR EVROPIANE PËR SHQIPËRINË

DOKUMENT INFORMUES

**Autorë:**

Ray Koçi    Rodjon Gjoka

**Janar 2022**

Copyright ASP 2022

**Akademia e Studimeve Politike**

Rruga "Emin Duraku", Pallati Credins Hyrja 1, kati 7, Ap. 21, Tiranë,

Tel: +355 4 5629047, E-mail: [info@asp.al](mailto:info@asp.al), Web: [www.asp.al](http://www.asp.al)

**Marrëveshja e Gjelbër Evropiane (MGJE)** (European Commission, 2019) është strategjia e kryesore e zhvillimit të Bashkimit Evropian drejt nxitjes së një modeli të qëndrueshëm ekonomik. E paraqitur në dhjetor 2019, objektivi kryesor i kësaj marrëveshjeje është që Evropa të bëhet kontinenti i parë me ndikim neutral ndaj klimës deri në vitin 2050, duke synuar ngritjen e një lëvizjeje të gjerë socio-ekonomike e kulturore mbi parimin e përmirësimit të shëndetit publik duke reduktuar ndotjen në gjithë komponentët pritës të mjedisit dhe duke siguruar energji të pastër nga burime të ripërtëritshme për sektorët e industrisë, transportit dhe banimit.

Marrëveshja e Gjelbër u krijua me synimin për të mbështetur arritjen e qëllimeve të përcaktuara nga “Marrëveshja e Parisit për Klimën”. Kjo e dyta, po ashtu e ratifikuar nga Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, angazhon nënshkruesit e saj që të ndërmarrin veprime për të siguruar që rritja mesatare globale e temperaturës të mbahet nën 2° dhe të vazhdojnë përpjekjet për të kufizuar ngrohjen globale në 1,5°.

Ballkani Perëndimor, ku bën pjesë dhe Shqipëria, është një nga rajonet Evropiane më të prekura nga ndikimi i ndryshimeve klimatike dhe ky trend parashikohet të vazhdojë, me vlerësime të rritjes së temperaturës prej 1.7 – 4.0°C, madje edhe tejkalimin e 5.0°C deri në fund të shekullit, në varësi të përpjekjeve globale për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë. Rritjet e temperaturave do të vënë në rrezik shumë sektorë. Konkretisht, Shqipëria është vlerësuar të jetë një nga vendet më vulnerabël në pellgun e Mesdheut sa i takon qoftë aftësisë për të përballuar efektet e ndryshimeve të klimës si edhe vetë amplitudës dhe frekuencës së eventeve të rrezikshme të lidhura me klimën. (IPCC Intergovernmental Panel on Climate Change, United Nations, 2021) . Për këtë arsye, fuqizimi i përpjekjeve për mbrojtjen e klimës dhe masat adaptuese në vendin tonë, por edhe rajon, është edhe më i rëndësishëm se në vende të tjera.

Nëpërmjet Marrëveshjes së Gjelbër, BE-ja vë theksin në mbështetjen e vendeve fqinje, duke pranuar se tranzicioni në kontinent mund të jetë plotësisht efektiv vetëm nëse ndërmerren veprime të ngjashme edhe përtej kufijve administrativë të Bashkimit. Me këtë qëllim, është hartuar **Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (AGJBP)** (European Commission, 2020) si një nga veprimet kryesore në kuadër të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Objektivi kryesor i kësaj agjende është caktimi i neutralitetit në ndikimin për klimën për vitin 2050 edhe në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, të cilat janë në procesin e para-anëtarësimit. Arritja e neutralitetit klimatik në vitin 2050, si hap i parë kërkon uljen e emetimeve të gazeve serrë me 55% deri në vitin 2030.

Udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor ranë dakord të miratojnë objektivat e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, më 10 nëntor 2020 duke nënshkruar **Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor** (Deklarata e Sofjes) (Regional Cooperation Council, 2020). Një vit më pas, më 6 tetor 2021, vendet e Ballkanit Perëndimor miratuan **Planin e Veprimit** për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor 2021-2030, i cili do të shërbejë si mjeti dhe udhëzuesi kryesor për arritjen e zotimeve të marra.

Njëkohësisht me objektivat ambicioze, Bashkimi Evropian e ka njohur rëndësinë e mbështetjes financiare të vendeve të Ballkanit Perëndimor në këtë drejtim zhvillimi të gjelbër. Orientimi i përbashkët i vendeve anëtare dhe rajonit tonë, synon krijimin e një potenciali të përbashkët për konkurrencën në tregjet globale në rritje për teknologji të qëndrueshme dhe të gjelbra. Agjenda e Gjelbër jo vetëm është e përfshirë në **Planin Ekonomik dhe të Investimeve 2020**, i cili synon të nxisë rimëkëmbjen afatgjatë të Ballkanit Perëndimor dhe konvergjencën e tij ekonomike me BE-në, por duket se zë pjesën themelore të tij pasi 70% e linjave kryesore të investimit lidhen drejtpërdrejt me transportin e qëndrueshëm, klimën dhe mjedisin dhe tranzicionin në energji të pastër. Në këtë prizëm, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një mundësi unike për të shfrytëzuar potencialin e zhvillimit të bazuar në tranzicion të qëndrueshëm dhe të drejtë dhe të përfitojnë më së miri nga procesi i anëtarësimit në BE për t'u ofruar qytetarëve të tyre mundësi të reja, punësim, siguri dhe drejtësi sociale.

Ky dokument ofron një përmbledhje të të gjitha mundësive dhe detyrimeve kryesore që dalin nga Agjenda e Gjelbër për Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Ndërsa arritja e objektivave të Agjendës së Gjelbër është një sfidë që kërkon përpjekje të konsiderueshme nga të gjithë sektorët dhe shoqëria në tërësi, hapi i parë duhet të jetë vendosja e një vizioni të qartë dhe vendosmëria nga politikëbërësit duke siguruar që vendi ynë të jetë konkurrues, i gjelbër dhe i drejtë për të gjithë qytetarët e tij (Robić, n.d.).

Kuvendi i Shqipërisë është një nga aktorët kryesorë drejt plotësimit të objektivave të Agjendës së Gjelbër dhe në përmirësimin e përsiatjeve aktuale ligjore për të përbushur kuadrin ligjor sipas kërkesave të Bashkimit Evropian lidhur me Marrëveshjen e Gjelbër, por dhe me Integrimin në përgjithësi.

Përtej nxitjes së nismave ligjore për arritjen e objektivave të vendosura, deputetët duhet të forcojnë rolin e tyre kontrollues ndaj veprimtarisë së ministrive të linjës mbi zbatimin e masave në fuqi dhe të iniciojnë mocione apo seanca pyetjesh, duke përforcuar llogaridhënien publike e qytetare ndaj marrjes së masave kundrejt realizimit të objektivave të një Shqipërie të gjelbër që synon të përbushë masat e kërkuara për integrim.

## II. POTENCIALI I AGJENDËS SË GJELBËR

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor është formuar rreth pesë shtyllave kryesore të mëposhtme nga ku lindin dhe detyrimet për secilin shtet:

### 1. Klima, Energjia dhe Mobiliteti (Dekarbonizimi)

Shqipëria, sikundër pjesa më e madhe e Ballkanit Perëndimor është një nga rajonet më të rrezikuara nga efektet e ndryshimeve klimatike. Prioriteti më urgjent është adaptimi i politikave të lidhura me klimën njëjtë me vendet e BE, të cilat do të qartësojnë edhe objektivat për tranzicionin e nevojshëm në sektorët e prodhimit dhe përdorimit të energjisë, mobilitetit dhe rritjes së shërbimeve nga ekosistemet, të cilat mund të përballojnë ndikimet nga ndryshimet klimatike dhe paralelisht të rrisin aftësinë përtëritëse të zonave që priten të preken nga evente të rrezikshme klimatike. Konkretisht, këto ndërhyrje kërkojnë reduktimin e emetimeve të gazeve serrë shoqëruar me dekarbonizim të sektorit industrial dhe transportit sikundër edhe rritjen e masave adaptuese ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike. BE-ja do të mbështesë përafrimin e rajonit tonë me ambicien për ta bërë Evropën një kontinent neutral ndaj karbonit deri në vitin 2050.

### 2. Lëvizja drejt një “ekonomie qarkulluese”

Orientimi i potencialit të rajonit drejt “ekonomisë qarkulluese” është thelbësore për BE-në dhe rajonin për të arritur tranzicionin e gjelbër. Kjo është edhe shtylla kryesore ku të gjithë sektorët e përmendur në këtë dokument mund të ballafaqojnë dhe adresojnë implikimet socio-ekonomike që kërkon një tranzicion i tillë gjithëpërfshirës. Koncepti Ekonomisë Qarkulluese në Shqipëri është ende i ri dhe duket abstrakt e futurist i trajtuar në rrethanat kur mbetjet ende nuk vlerësohen për potencialin që kanë, por shihen si eksternalitete mbi të cilat mbetet ende sfidë fillestare depozitimi dhe trajtimi. Nën konceptin e ekonomisë qarkulluese ndryshon pesha specifike që ka ekonomia e tregut kundrejt burimit apo lëndës së parë të përdorur duke marrë rëndësi të lartë cikli i jetës që do të ketë produkti i prodhuar pasi të ketë përfunduar shërbimin e ofruar. Lënda e parë duhet të qarkullojë sërish në treg për arsye ripërdorimi, riciklimi dhe kjo arrihet duke ndërhyrë që në fazën e konceptimit të produktit.

### 3. Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës

Ndotja e ajrit në Ballkanin Perëndimor është një nga më të lartat në Evropë dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e qytetarëve, kështu që synimi në këtë fushë i AGJBP është të mbështesë përpjekjet për uljen e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës. Vetëm nga ndotja e Ajrit në Shqipëri vlerësohet të kemi implikime ekonomike-shëndetësore për të paktën 1 në 12 persona ndërkohë që Agjencia Europiane e Mjedisit në raportin e vitit 2021 vlerëson që nga ndotja e ajrit regjistrohen të paktën 2.800 vdekje të parakohshme çdo vit (European Environmental Agency,

2021) krahas dhe 724 vdekje te parakoheshme nga ndotja e ajrit në ambientet e brendshme për shkak të përdorimit të lëndëve djegëse të ngurta (*Global Health Effects Insitute, 2019*).

#### **4. Ndërtimi i sistemeve të qëndrueshme të bujqësisë dhe ushqimit**

Kjo shtyllë synon promovimin e metodave të qëndrueshme të prodhimit dhe furnizimit me ushqim duke qënë se Bujqësia dhe sektorët e ndërlidhur kontribuojnë në rreth 10% në PBB në Ballkanin Perëndimor. Njëkohësisht, Energjia dhe BPPTT (Bujqësia, Pyjet dhe Përdorimet e Tjera të Tokës) janë kontribues kryesorë në emetimin e gazeve me efekt serrë (GES) në Shqipëri (*Raporti i parë dyvjeçar i përditësuar për Shqipërinë – UNDP, 2021*). BPPTT, dhe bujqësia në veçanti, do të preket thellë nga ndryshimet klimatike duke marrë parasysh rritjen e shpeshtisë dhe intensitetit të përmytjeve dhe thatësisë, të cilat do ndikojnë drejtpërdrejtë në gatishmërinë e burimeve ujore në shërbim të sektorit. Masat në këtë sektor do të kërkojnë angazhim në ndryshimin e praktikave aktuale bujqësore dhe të prodhimit të lëndës ushqimore në vend duke mbajtur parasysh qëllimin e rritjes së prodhimit dhe rendimentit pa ndikuar në elemente si popullata e bagëtive, të cilat janë kyçe për arritjen e qëllimeve të Shqipërisë për nxitjen e prodhimit bujqësor.

#### **5. Mbrojtja e biodiversitetit dhe ekosistemeve**

Kjo shtyllë ka si objektiv mbrojtjen e biodiversitetit dhe restaurimin e ekosistemeve duke mbajtur parasysh shfrytëzimin e potencialit të madh turistik të rajonit. Biodiversiteti dhe ekosistemet do të ekspozohen me shpejtësi ndaj rritjes së temperaturës për shkak të ndryshimeve klimatike dhe njëkohësisht ndaj ndikimit mjedisor të “korrjes” së energjisë me metodat tradicionale, apo hidrocentralet. Kjo qasje sjell shndërrim dhe shkretim të ekosistemeve me kosto të mëdha rrjedhëse ekonomike e mjedisore. Përtej hartimit të dokumentave strategjike dhe planeve të veprimit, AGJBP vendos theks të veçantë në vlerësimin e veprimtarive që lidhen me mbrojtjen dhe restaurimin e diversitetit e ekosistemit, caktimin e kornizave të monitorimit, fuqizimin e mekanizmave të raportimit dhe planifikimit të përbashkët rajonal dhe zhvillimin e infrastrukturës mbështetëse në shërbim të lidhshmërisë së ekosistemeve.

Paralelisht, BE vendos theksin në zhvillimin dhe përpjekjet në digjitalizim të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si një mundësi thelbësore për zhvillimin e objektivave të pesë shtyllave të mësipërme, në përputhje me konceptin e tranzicionit të dyfishtë të gjelbër dhe digjital.

Me nënshkrimin e Deklaratës së Sofjes, vendi ynë është zotuar gjithashtu për të ndërmarre veprimet e nevojshme për rritjen e kapaciteteve administrative për zbatimin e Agjendës së Gjelbër. Përmirësimi i qeverisjes ndërsektoriale, duke përfshirë reformën e administratës publike, menaxhimin e financave publike, programin e reformës ekonomike dhe mobilizimin e burimeve të brendshme, është një nga mekanizmat kryesorë për të siguruar zbatimin e veprimeve të dakordësuara në Deklaratën e Sofjes.

### III. REKOMANDIME PËR POLITIKËBËRËSIT

Bazuar në analizën e situatës aktuale dhe të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Gjelbër, mund të ofrohen disa rekomandime konkrete për orientimin e politikave dhe reformave konkrete në Shqipëri, të grupuara në pesë shtyllat përkatëse:

#### Klima

- Për të bashkërenduar dhe faktorizuar inisiativën e marrëveshjes së gjelbër dhe marrëveshjes së Sofjes është e nevojshme që të krijohet një kuadër ligjor mundësues me spektër të gjerë, i cili synon ndërtimin dhe zbatimin e programit “Climate Neutral Albania 2050”.
- Qartësisht një tranzicion i tillë do të impaktojë ekonominë dhe shoqërinë shqiptare po aq sa edhe vendet e tjera të rajonit, për rrjedhojë është e domosdoshme që të themelohet “Komiteti i Dekarbonizimit”, si një strukturë ndërministrore, mandati i të cilit të synojë që brenda vitit 2024 të ketë zhvilluar Plan Veprimin për Dekarbonizimin e Shqipërisë. Me qëllim bashkërendimin e detyrave të ministrive dhe institucioneve publike/private, mund të ngrihet dhe funksionojë grupi ndërministror i punës (Komiteti Kombëtar për Ndryshimet Klimatike), me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit, ku pjesë themelore e këtij grupi duhet të jetë Komiteti i Dekarbonizimit.
- Në vijim të miratimit të strategjisë dhe kuadrit ligjor për Klimën, vendi ynë duhet të zhvillojë dhe aprovojë plan-veprimet me objektiva të qartë për dekarbonizimin e sektorëve të industrisë, transportit, bujqësisë, mbetjeve, ndërtimtarisë. Këto plan veprime duhet të jenë të konsultura me të gjithë grupet e interesit në një proces të hapur ku vendimarrja duhet të jetë konsensuale dhe jo mbi principin e shumicës mbi pakicën.
- Paralelisht, në linjë me Strategjinë e Adaptimit të BE, Shqipëria duhet të hartojë dhe miratojë në nivel kombëtar dhe lokal Planet e Resiliences dhe/ose Planet e Reduktimit të Riskut nga Klima, ku objektivi kryesor është hartimi i projekt-ideve dhe planeve sektoriale ku do të propozohen ndërhyrje me bazë natyrën për të zvogëluar sa më shumë impaktet e pritshme nga ndryshimet klimatike në territor, ekonomi dhe popullatë.
- Gjithashtu brenda vitit 2024 Shqipëria duhet të ndërtojë një sistem të kompletuar monitorimi lidhur me emetimet e gazeve të efektit serrë dhe ndotës në atmosferë, kjo sipas një metodologjie të përafuar me udhëzuesin e Panelit Ndërqeveritar të Ndryshimeve Klimatike dhe Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike për

grumbullimin e të dhënave, llogaritjen dhe raportimin e tyre. (Regional Cooperation Council, 2021)

## Energjia

- Në sektorin e energjisë elektrike është e domosdoshme ndërhyrja e menjëhershme për të përafuar dispozitat e mbetura nga Paketa III e Energjisë si edhe nga Paketa e Energjisë së Pastër nën Traktatin e Komunitetit të Energjisë.
- Autoritetet qendrore duhet të vlerësojnë vulnerabilitetin dhe varësinë e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet ujore, hidrocentralet, si një marrëdhënie e paqëndrueshme dhe tërësisht në varësi të kushteve meteorologjike dhe projeksioneve klimatike në ndryshim. Kësisoj, Shqipëria duhet të synojë diversifikim me energji të rinovueshme (solar, eolik) të shportës totale të energjisë që shkon për konsum. Inisiativa për prodhimin e energjisë nga termocentrali i Vlorës dhe i Korçës (projekt-ide) nuk janë tërësisht në linjë me dekarbonizimin e sektorit të energjisë, por vetëm me synimin e diversifikimit të burimeve të gjenerimit. Gjithashtu është e nevojshme një skemë mbështetëse në shkallë kombëtare për të nxitur auto-konsumin nga burime të rinovueshme edhe për klientët familjarë.
- Agjensia e Efiçensës së Energjisë duhet të hartojë dhe zbatojë një plan veprimi për rinovimin e stokut të ndërtesave nën principin e rritjes së performancës së tyre energjitike. Gjithashtu nëpërmjet të njëjtit autoritet duhet të instalojë një mekanizëm kontrolli, i cili verifikon dhe lejon në tregun vendas përdorimin e pajisjeve me konsum efiçent të energjisë.
- Rregulloret dhe incentivat ekonomike duhet të përshpejtojnë instalimin e një rrjeti të dedikuar për furnizimin e mjeteve elektrike në të gjithë territorin e vendit.
- Në sektorin e industrisë kërkesa për energji mbetet e lartë dhe si rrjedhojë burimet kryesore të saj janë lëndët djegëse fosile. Vendi ynë duhet të zhvillojë brenda vitit 2023 një paketë ligjore, standartesh dhe rregullore për prodhimin dhe përdorimin e lëndëve djegëse alternative, që mund të përpunohen nga sektori i mbetjeve urbane, mbetjeve industriale dhe sektori bujqësisë.
- Së fundi, në listën e ndërhyrjeve më prioritare në sektorin e energjisë është rregullimi sipas një skeme transparente dhe të qëndrueshme të Varfërisë Energjitike. Vendi ynë fillimisht duhet ta njohë ligjërisht këtë fenomen, duke përcaktuar qartë grupet që futen në

kategorinë e varfërisë energjitike si edhe mekanizmin me të cilin ata do të mbështeten për të siguruar minimumin e sasisë energjitike të nevojshme për konsum në familje.

## Transporti

- Nevojitet diversifikimi i mënyrës së lëvizjes së mallrave dhe njerëzve brenda territorit të vendit dhe ndërlidhjes me rrjetet infrastrukturore të vendeve fqinjë. Orientimi drejt rrjeteve hekurudhurore duhet të shoqërohet me zhvillimin e mekanizmave mbështetës për automjetet elektrike dhe kushtëzues për të limituar përdorimin e automjeteve që përdorin lëndë djegëse fosile sidomos në qytetet ku dendësia e popullsisë është tepër lartë.
- Qytetet si Tirana, Elbasani, Durrës, Fier, Vlorë etj duhet menjëherë të zhvillojnë, miratojnë dhe zbatojnë strategji të qarta për krijimin e zonave me emetim të ulët dhe ultra të ulët nga sektori i transportit. Kjo mund të kërkojë elektrifikimin dhe intensifikimin e modaliteteve të transportit publik si edhe kushtëzimin e tipologjisë së automjeteve private që mund të përdoren në këto zona urbane. Qëllimi i kësaj ndërhyrje është legjitim jo vetëm në kontekstin e dekarbonizimit dhe agjendës së gjelbër, por mbi të gjitha për të reduktuar impaktin e lartë që transporti ka në shëndetin publik si pasojë e përqendrimit të lartë të ndotjes së çliruar në ajrin urban.

## Ekonomia Qarkulluese

- Shqipëria duhet të ketë hartuar brenda vitit 2023 Strategjitë Sektoriale që do të mundësojnë tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese për sektorin e industrisë prodhuese, përpunuese, menaxhimit të mbetjeve dhe ndërtimtarisë. Paralelisht, nevojitet të zhvillohet mekanizmi që mundëson tregtimin dhe gjurmimin e karbonit. Një domosdoshmëri kjo në kushtet kur tregjet Europiane parashikohet të pranojnë produkte të cilat kanë zero efekt në klimë dhe prodhuesit vendas duhet të shmangin bllokimin e mundshëm të eksporteve duke incentivuar sektorët e lartëpërmendur me plane e modele biznesi, subvencione dhe konsulence teknike që të adaptojnë dekarbonizimin total deri në vitin 2045.
- Sa i takon sektorit të menaxhimit të mbetjeve, Shqipëria pozicionohet jo korrekt në hierarkinë e instaluar për mënyrën si menaxhohen mbetjet. Reformimi këtij sektori shihet si një mundësi e mirë për të zgjidhur problemet ekzistuese, por edhe për ta orientuar më tutje në përputhje me parashikimet e Direktivës Kuadër të BE për Menaxhimin specifik të secilës prej rrymave të mbetjeve.



## Ndotja

- Kapitulli i mjedisit në procesin e anëtarësimit të vendit tonë drejt BE do të jetë qartësisht kapitulli me kushtet më të vështira dhe barrën ekonomike më të rëndë. Rrjedhimisht duhet që kësaj sfide t'i paraprihet duke vendosur objektiv primar të qartë forcimin e kapaciteteteve të Ministrisë së Mjedisit ku pesha e përgjegjësisë mbi Turizmin, që kjo ministri mban sot, mund të delegohet në një nga Ministrinë e tjera.
- Brenda vitit 2022 vendi ynë duhet të ndërmarrë hapa që në buxhetin e planifikuar për vitin pasardhës të dedikojë investime për të vënë në zbatim parashikimet dhe arritur objektivat e parashikuar në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit (Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2019). Shqipëria është një nga vendet e vetme në rajon që nuk monitoron dhe as raporton përqendrimin e ndotësve në ajrin urban. Në të gjitha matjet alternative të zbatuara gjatë pesë viteve të fundit rezultoi se ndotësit PM2.5, PM10 dhe NO2 janë shqetësuese e në nivele mbi standartet e lejuara nga kuadri ligjor vendas (Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, 2021).
- Shqipëria duhet të përafrojë brenda vitit 2025 të gjithë setin e Teknikave më të Mira në Dispozicion (BAT) si edhe të përafrojë e zbatojë në tërësi Direktivën për Emetimet Industriale. Shkarkimet industriale dhe të mbetjeve në tokë dhe trupa ujorë është një nga fenomenet më shqetësuese. Të gjithë industrinë, bizneset dhe veprimtaritë e ndryshme që gjenerojnë shllam, mbetje të lëngëta etj, shkarkojnë në rastin më të mirë nëpërmjet një paratrajtimi shumë elementar të gjithë ndotjen në kanale, përrenj e lumenj. Rekomandohet që Agjensia Kombëtare e Mjedisit të shtojë kapacitetet njerëzore dhe teknike sidomos në inspektimi dhe verifikim e raportimeve nga palët të treta.
- Është urgjente forcimi i mekanizmit monitorues dhe kontrollues të ndotjes nga zhurmat. Vlerësohet se janë të paktën 315 mijë qytetarë të ekspozuar ndaj kësaj ndotjeje të paktën për 5-7orë në ditë. (Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, 2021). Ekspozimi ndaj këtij fenomeni fizik nuk shkakton vetëm probleme në aparatit e dëgjimit tek njeriu, por është provuar që rrit riskun me të paktën 80% që i ekspozuari të kalojë në depresion. Insitiuti i Shëndetit Publik, prej vitit 2014 nuk përmbush detyrimin ligjor për të publikuar raportin vjetor mbi Cilësinë e Shëndetit Publik në Shqipëri.
- Në lidhje me shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, edhe pse është investuar në ndërtimin e të paktën 7 impianteve të trajtimit të ujit të ndotur urban, duhet theksuar se vetëm gjysma e tyre kryejnë procesin e pastrimit të plotë dhe uji i trajtuar mund të konsiderohet mjaftueshëm i pastër për t'u shkarkuar në trupat ujorë pritës në natyrë.

Ndërkohë pjesa tjetër bën vetëm nje trajtim mekanik për të larguar mbetjet e mëdha nga ujrat e ndotura por jo ndotësit, ndërkohë që 2/3 e bashkive në vend shkarkojnë ujrat e ndotura direkt në trupat ujqor pritës, siç është edhe rasti UKT me shkarkimet e drejtpërdrejta të ujrave të ndotura në seksionin e lumit Lanë, brenda zonën historike të qytetit.

## **Bujqësia e Qëndrueshme**

- Në fushën e Bujqësisë mbetet me rëndësi bashkërendimi i përpjekjeve ndërsektoriale dhe vendosja e masave më konkrete drejt reformave strukturore që do të mundësojnë përmirësimin e efiçencës në prodhimin bujqësor, aksesin e produkteve bujqësore vendase në tregun vendas dhe atë evropian si dhe të punohet më tej në lehtësimin e aksesit të bizneseve dhe fermave në skemat e mbështetjes financiare duke përfshirë aspektet e ndryshimit klimatik.
- Në programet dhe instrumentat aktuale të mbështetjes financiare, teknike dhe kapacituese në sektor, si Programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2021-2027 në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPARD) (2021-2027) rekomandohet të integrohet ndryshimi dhe nxitja e praktikave të qëndrueshme si indikatorë themelorë të përfitimit dhe avancimit në të ardhmen.

Në mënyrë që vulnerabiliteti dhe dobësitë të pritshme ndaj risqeve natyrore të mos rrënjosen si një gjendje permanente në vendin tonë, sugjerojmë që brenda vitit 2022 të ngrihet një taks-forcë me mandat 7-vjeçar, e cila tejkalon mandatin qeverisës, dhe ka në përbërje të saj përfaqësi të qeverisë qendrore, vendore, donatorë, biznesi dhe shoqëria civile. Kjo task-forcë duhet të veprojë në koordinim të drejtpërdrejtë me Kuvendin e Shqipërisë dhe komisionet parlamentare si edhe Ministrinë e Mjedisit. Detyra themelore e saj është e nevojshme të jetë konsultimi dhe zhvillimi i opionecave kundrejt politikave, strategjive, planeve të hartuara nën nismën “Climate Neutral Albania 2050” si edhe ofrojë monitorim dhe raportim të zbatimit praktik të gjithë nismave të miratuara.

Tranzicioni i gjelbër përbën një sfidë të vështirë për vendimmarrësit, por është një udhëtim që nuk mund të shmanget. Politikëbërësit është e nevojshme që të mendojnë përtej mandatit të tyre dhe të krijojnë frymën e duhur mes palëve dhe aktorëve të ndryshëm për të siguruar ndërhyrje dhe plane investimesh afatgjata. Ky zhvillim mund të shënojë fundin e tranzicionit politik dhe ekonomik në Shqipëri, duke treguar maturi për të hyrë në një fazë tjetër tranzicioni, në të cilën mësimet e kësaj periudhe mund të vlejnjë më tepër nga sa mendojmë.

## REFERENCAT

Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, 2021. *Raporti Mushkëri të Gjelbra*, Tiranë: Co-PLAN.

European Commission, 2019. *The European Green Deal*. [Online]

Available at: [file:///C:/Users/rodion\\_gjoka/CO-](file:///C:/Users/rodion_gjoka/CO-PLAN/Downloads/The%20European%20Green%20Deal%20sets%20out%20how%20to%20make%20Europe%20the%20first%20climate-neutral%20continent%20by%202050%20boosting%20the%20economy%20improving%20people's%20health%20and%20quality%20of%20life%20caring%20for%20nature%20and%20leaving%20no%20one%20behind.pdf)

[PLAN/Downloads/The European Green Deal sets out how to make Europe the first climate-neutral continent by 2050 boosting the economy improving people s health and quality of life caring for nature and leaving no.pdf](file:///C:/Users/rodion_gjoka/CO-PLAN/Downloads/The%20European%20Green%20Deal%20sets%20out%20how%20to%20make%20Europe%20the%20first%20climate-neutral%20continent%20by%202050%20boosting%20the%20economy%20improving%20people's%20health%20and%20quality%20of%20life%20caring%20for%20nature%20and%20leaving%20no%20one%20behind.pdf)

[Accessed 15 2 2022].

European Commission, 2020. *Green Agenda for the Western Balkans*, Brussels: EC.

European Commission, 2021. *Albania Progress Report*, Belgium: EC.

European Environmental Agency, 2021. *Air Quality in Europe 2021*, Copenhagen: EEA.

Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2019. [Online]

Available at: <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-412-2019-menaxhimi-i-ajrit.pdf>

[Accessed 22 January 2022].

IPCC Intergovernmental Panel on Climate Change, United Nations, 2021. <https://www.ipcc.ch/>. [Online]

Available at: <https://www.ipcc.ch/report/sixth-assessment-report-working-group-i/>

[Accessed 16 2 2022].

Regional Cooperation Council, 2020. *Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans*.

[Online]

Available at: <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-rn>

[Accessed 9 Februarz 2022].

Regional Cooperation Council, 2021. *Action Plan for the Implementation of Sofia Declaration*, Brussels: October.

Robić, D. S., n.d. *CLEANING ENERGY SOURCES, PROTECTING THE CLIMATE – CAN WESTERN BALKANS RISE UP TO THE CHALLENGE?*, s.l.: s.n.

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, 2021. *Raporti i Parë të Dyvjeçar i Përditësuar në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike*, Korrik 2021